



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2022

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 21.09.2022)

Pika 1 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Për hapjen e procedurës së transferimit të përkohshëm për një pozicion të lirë në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Krujë”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Alban Toro).

Drejton mbledhjen Zëvendëskryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, zoti Ilir Rusi.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:00 dhe mbaroi në orën 12:20.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. ***Ilir Rusi*** (zëvendëskryetar)
2. ***Klodian Kurushi*** (anëtar)
3. ***Fatmira Luli*** (anëtare)
4. ***Irena Plaku*** (anëtare)
5. ***Dritan Hallunaj*** (anëtar)
6. ***Ridvan Hado*** (anëtar)
7. ***Alban Toro*** (anëtar)
8. ***Marçela Shehu*** (anëtare)
9. ***Yllka Rupa*** (anëtare)

Shënim: Nuk mori pjesë në mbledhje Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, *znj. Naureda Llagami*, si dhe nuk mori pjesë në mbledhje anëtarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, *znj. Brikena Ukperaj*.

Merrnin pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

- 1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.*
- 2. Luan Dibra, Drejtor i Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.*
- 3. Maela Alicanaj, Këshilltare Ligjore pranë Njesisë Mbështetëse të Komisioneve të Përhershme të Këshillit.*
- 4. Staf administrativ i KLGJ-së.*

RENDI I DITËS:

1. Shqyrtimi i projektvendimit “Për hapjen e procedurës së transferimit të përkohshëm për një pozicion të lirë në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Krujë”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Alban Toro).

Ilir Rusi: Përshëndetje të nderuar anëtarë të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Sipas njoftimit të bërë, deklaroj të hapur mbledhjen e ditës së sotme, datë 21 shtator 2022, ora 15:45. Meqenëse edhe infrastruktura është gati, si në raport me regjistrimin, ashtu edhe me aktet përkatëse, meqenëse edhe kuorumi është i nevojshëm, mbledhjen e deklaroj të hapur.

Sikundër jeni njoftuar kohë më parë, në e-mailin e datës 16 shtator 2022, jemi njoftuar që në datë 23 shtator 2022, ora 11:30 do të mbahet mbledhja plenare e Këshillit të Lartë Gjyqësor, ku ndër të tjera, në pikën 2 të saj ishte përcaktuar që do të bëhej shqyrtimi i projektvendimit “Për hapjen e procedurës së transferimit të përkohshëm për një pozicion të lirë në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Krujë”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës, me relator zotin Alban Toro.

Nisur nga e-maili i ardhur ditën e sotme, datë 21 shtator 2022 ora 14:45 nga zonja Maela Alicanaj, në emër të Komisionit të Zhvillimit të Karrierës, është kërkuar që me

porosi të kryetarit të Komisionit të Zhvillimit të Karrierës dhe të vetë Komisionit të Zhvillimit të Karrierës është kërkuar që afati për shqyrtimin e projekt-aktit “Për hapjen e procedurës së transferimit të përkohshëm për një pozicion të lirë në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Krujë” (çështjen që përmenda më sipër), përfundon sot. Duke qenë se kjo çështje është planifikuar të trajtohet në mbledhjen e datës 23 shtator, me qëllim respektimin e afatit ligjor të transferimit, të mundësohet që kjo çështje të trajtohet në një mbledhje të organizuar ditën e sotme. Sipas Komisionit të Zhvillimit të Karrierës, propozohet që kjo mbledhje të zhvillohet në orën 15:15.

Për shkak të dakordësisë të gjashtë anëtarëve të Këshillit të Lartë Gjyqësor në lidhje me këtë ndryshim të rendit të ditës të datës 23 dhe kjo çështje, pika 2 e saj, të shqyrtohet sot, atëherë ju kam njoftuar për të mbajtur mbledhjen e ditës së sotme e cila në pikën e parë do të ketë shqyrtimin e projektvendimit “Për hapjen e procedurës së transferimit të përkohshëm për një pozicion të lirë në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Krujë”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës, relator z. Alban Toro.

Meqenëse po ditën e sotme, nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës është kërkuar edhe shqyrtimi i disa rasteve urgjente në lidhje me caktimin e gjyqtarëve për çështje të veçanta në gjykata, mbledhje për të cilën u planifikua për t’u zhvilluar ditën e nesërme, ora 9:00, për menaxhim të kohës, po në këtë mbledhje do të shqyrtohen edhe këto kërkesa të bëra nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës për caktimin e gjyqtarëve për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në gjykata të tjera, të ndryshme nga ajo ku ushtrojnë funksionet në mënyrë të përhershme, me relator z. Klodian Kurushi.

Për më tej, fjalën ia jap zotit Toro për të relatuar për pikën e parë.

Ju faleminderit!

Alban Toro: Të falënderoj zoti Zëvendëskryetar, në mënyrë të veçantë për efikasitetin e ushtruar.

Prej kohësh Gjykata e Rrethit Gjyqësor Krujë ka qenë një nga gjykatat e përcaktuara nga Këshilli i Lartë Gjyqësor si gjykatë në nevojë dhe në këtë kuadër, me vendimin nr. 363, datë 14.09.2021 është marrë vendimmarrja në bazë të së cilës Këshilli ka vendosur: Transferimin e përkohshëm me pëlqim në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor

Krujë të gjyqtares znj. {...}, për një periudhë deri në një vit, që mund të ndërpritet në rast të ndryshimit të rrethanave që kushtëzuan transferimin.

Sipas Dekreti të Presidentit të Republikës nr.7818, datë 16.11.2012, i ndryshuar, organika e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Krujë është 4 (katër) gjyqtarë, (konkretisht gjyqtarja {...}, gjyqtarja {...}, ndërkohë që gjyqtarja znj. {...} me vendim nr. 432, datë 14.10.2020 të Këshillit të Lartë Gjyqësor, është komanduar ndihmësmagjistrate në Gjykatën e Lartë deri më 20.10.2023, si dhe magjistratja {...}).

Bashkëlidhur këtij relacioni ju kam paraqitur në mënyrë grafike ngarkesën e të dy gjykatave për gjashtëmujorin e parë janar 2022 – qershor 2022, respektivisht të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Krujë dhe të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, ku të dy gjykatat kanë një numër të madh çështjesh gjyqësore.

Gjithsesi, duke u konsideruar Gjykata e Rrethit Gjyqësor Krujë si një gjykatë në nevojë, nga ana e Komisionit janë vlerësuar të gjitha skemat e mundshme të cilat mund të normalizonin aktivitetin e kësaj gjykate. Skema e delegimit nuk mund të funksiononte në rastin konkret pasi të 11 gjyqtarët e komanduar tashmë në këtë skemë ushtrojnë funksionin e tyre për të normalizuar funksionalitetin e disa gjykatave të apelit të juridiksionit të përgjithshëm dhe e kanë të pamundur që të kontribuojnë edhe për Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Krujë. Gjithashtu nuk mund të vijë në ndihmë as rregullorja e miratuar nga ana e Këshillit, vendimi nr.30, datë 14.02.2019 për shkak të vetë ngarkesës që ka Gjykata e Rrethit Gjyqësor Krujë dhe specifikës që mbulon kjo rregullore.

Kështu që, i vetmi mjet ligjor u parapa dhe u përcaktua të ishte skema e transferimit, përcaktuar kjo me vendimin nr.23, datë 07.02.2019 të Këshillit të Lartë Gjyqësor “Mbi miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurën e transferimit të përkohshëm të gjyqtarit” (i ndryshuar). Kështu që në këtë kuadër, duke marrë parasysh dhe dispozitën e nenit 5 të kësaj rregulloreje, në kushtet kur për nevojat e kësaj gjykate, në të cilën ka të transferuar përkohësisht me pëlqim një gjyqtar, mund të përmbushet sërish vetëm përmes transferimit të përkohshëm, Këshilli shpall pozicionin e lirë të përkohshëm duke ftuar, fillimisht, për të dhënë pëlqimin, gjyqtarin që është i transferuar në atë gjykatë, nëse transferimi i tij nuk cenon funksionalitetin e gjykatës ku ai është

caktuar në mënyrë të përhershme.

Kështu që, për ta mbyllur, nga ana e Komisionit është përgatitur drafti përkatës në dispozitivin e të cilit ju sugjerohet të miratoni:

1. Të shpallë një pozicion të lirë në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Krujë për transferim të përkohshëm deri më datë, dhe në rastin konkret ju është propozuar data 01.05.2023, duke marrë në konsideratë vullnetin e Këshillit si dhe parashikimit që është bërë për riorganizimin e gjykatës së shkallëve të para të juridiksionit të përgjithshëm, që sipas pikës 1 të vendimit 495, 21.07.2022 të Këshillit të Ministrave “Për riorganizimin e rretheve gjyqësore dhe kompetencave tokësore të gjykatave”. Pra e theksoj, ju propozohet data 01.05.2023.

2. Kjo shpallje i drejtohet gjyqtarës së transferuar, aktualisht në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Krujë, znj. {...}, e cila të ftohet për të dhënë pëlqimin për përsëritjen e transferimit të përkohshëm.

3. Afati për dhënien e pëlqimit të jetë brenda dy ditëve nga njoftimi i këtij vendimi.

4. Ngarkohet Komisioni i Zhvillimit të Karrierës për ndjekjen e hapave të mëtejshëm të procedurës së transferimit të përkohshëm.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Faleminderit!

Ilir Rusi: Faleminderit zoti Toro!

Ka ndonjë diskutim nga anëtarët e tjerë të Këshillit mbi çfarë u prezantua nga zoti Toro?

Klodian Kurushi: A mund të flas?

Faleminderit zoti Rusi!

Në këtë relatim unë dakordësohem me të gjitha në relacionin përkatës. Është relacion i ardhur sigurisht nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës. Vetëm, edhe një herë ndoshta nuk arrita të kuptoj pjesën e fundit të propozimit, datën për transferimin e

përkohshëm. Pra nëse është e mundur: “Të shpallë një pozicion të lirë në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Krujë për transferim të përkohshëm deri më datë?”.

Alban, më ndjek?

Ilir Rusi: Zoti Toro, diçka?

Zoti Kurushi, mund ta parashtrosh edhe një herë atë çfarë thatë në raport me zotin Toro, sepse mbase e nuk ka kuptuar dhe nuk po ndërhyr për të thënë mendimin e vet.

Klodian Kurushi: Për të qenë i qartë, edhe një herë.

Në relacionin përkatës dhe në projektvendim, në pikën e parë të projektvendimit thuhet, propozohet të vendoset “Të shpallë një pozicion të lirë në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Krujë për transferim të përkohshëm deri më datë?”, -nuk e kuptova pra deri në çfarë date duhet të shpallet.

Dritan Hallunaj: Më falni! Deri më datë 01.05.2023.

Ilir Rusi: Me atë çfarë prezantoi zoti Toro, referoi përcaktimet që janë bërë në vendimin e Këshillit të Ministrave të muajit korrik të vitit 2022 në lidhje me hartën e re gjyqësore dhe meqenëse është një gjykatë e shkallës së parë e juridiksionit të përgjithshëm, propozoi që afati i transferimit të jetë deri në datën që përcaktohet që gjykatat e shkallës së parë me juridiksion të përgjithshëm do të riorganizohen dhe vendimi i Këshillit të Ministrave ka përcaktuar datën 1 maj 2023 në lidhje me riorganizimin. Transferimi do të përkohë në lidhje me këtë afat kohor që është përcaktuar nga vendimi i Këshillit të Ministrave. Kjo është parashtrësja e relatorit, z.Toro.

Klodian Kurushi: Perfekt. Domethënë, për ta përforcuar ose për të qenë më të qartë, mund të vendoset në dispozitivin e projektit që propozojmë ne “deri në datën 01.05.2023”?

Ilir Rusi: Kjo është parashtrësja e zotit Toro.

Megjithatë, zoti Toro ka marrë fjalën dhe mund të shpjegojë më tej.

Alban Toro: Klodi, se kisha probleme teknike dhe nuk po dëgjoja gjë.

Nuk kuptoj, çfarë nuk kupton nga paragrafi?

Më dëgjon?

Klodian Kurushi: Alban faleminderit!

Kuptoj gjithçka, jemi shumë të qartë.

Vetëm se do doja që...

Alban Toro: Afati maksimal është deri në 01.05 sepse ky ka qenë të themi edhe vullneti i shumicës në raste të ngjashme, për të kufizuar me afatet që ka përcaktuar vendimi i qeverisë për riorganizimin, pra nuk mund të shkojë 1 vit. Dikur e kemi pasur me afat maksimal 1 vit.

Klodian Kurushi: E kuptova Alban.

Pra duhet të shënojmë 01.05.2023?

Dakord, jam i qartë. Dakordësohem edhe unë me këtë.

Alban Toro: S'e di, a dëgjohem qartë apo jo?

Klodian Kurushi: Dëgjohesh.

Alban Toro: Okej!

Ilir Rusi: Ka diskutime nga anëtarë të tjerë të Këshillit në lidhje me këtë çështje?

Irena Plaku: Ta marrë unë fjalën?

Sepse tani u njoha me aktet dhe nuk i kisha lexuar për sot.

Shikoj që janë statistikat e qershorit?

Po kërkesa është paraqitur tani apo...? Dhe pse janë marrë në qershor? Pse s'janë marrë të rifreskuara statistikat?

Alban Toro: Sepse aktualisht departamentet përkatëse këtë...

Irena Plaku: Sepse shoh që nga gjykata e Krujës janë tre gjyqtarë gjithsej ku përfshihet edhe Kostandina.

Alban Toro: Irena, aktualisht departamenti përkatës që mbulon pjesën e statistikës disponon këto lloj të dhënash, gjashtëmujorin e parë, dhe këto të dhëna që disponon ky departament janë përdorur për të përgatitur këtë relacion.

Irena Plaku: Po mendimin e kryetarit? Apo s'është marrë?

Alban Toro: Ajo është pjesë e fazës së dytë ku përfshihet pëlqimi i zonjës në fjalë.

Irena Plaku: Në rregull. Thashë që nuk e kam lexuar relacionin, se tani për momentin më erdhi.

Alban Toro: Jo, jo, keni të drejtë në këtë pjesë. Emergjencat gjithmonë i sjellin këto probleme.

Por ajo është pjesë e fazës së dytë, ku merret pëlqimi i zonjës në fjalë dhe njëkohësisht opinionin përkatës i kryetares i cili përfshihet në relacionin e dytë që do të bëhet për këtë punë (ndoshta mundësisht, eventualisht brenda të premtës). Si ta dëshirojë Këshilli.

Irena Plaku: Në rregull.

Ilir Rusi: Ka diskutime nga anëtarët e tjerë të Këshillit?

Meqenëse kaloi një kohë e arsyeshme e pritjes për mendime të tjera, duke marrë në konsideratë faktin që mbledhja është “online”, do kalojmë në votimin e projekt-aktit përkatës, me përcaktimin e afatit kohor të bërë nga zoti Toro, për të cilin pati edhe komentimin përkatës nga kryetari i Komisionit të Zhvillimit të Karrierës, duke përcaktuar që: “Të shpallë një pozicion të lirë në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Krujë për transferim të përkohshëm deri në datën 01.05.2023.

Kalojmë në votimin e projekt-aktit përkatës me këtë ndryshim.

Zonja Plaku!

Irena Plaku: Dakord.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ilir Rusi: Zoti Hado!

Alban Toro: Më duket se votoi me shkrim. Duhet të ketë problem me audion.

Ilir Rusi: Atë po verifikoj.

I thonë me “SMS”.

(Zoti Hado voton nëpërmjet chat-it të platformës (citohet): “Ndjese për mungesën e audios, votoj Pro projektvendimit sipas propozimit”.)

Zoti Toro!

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Marçela Shehu: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Klodian Kurushi: Dakord.

Ilir Rusi: Dakord.

Miratohet projekt-akti përkatës, i cili kthehet në vendim “Për hapjen e procedurës së transferimit të përkohshëm për një pozicion të lirë në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Krujë”.

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në nenin 46, të ligjit 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, në vendimin nr. 23, datë 07.02.2019 të Këshillit të Lartë Gjyqësor “Mbi miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurën e transferimit të përkohshëm të gjyqtarit” me ndryshime, duke konstatuar

edhe cenimin e rëndë të funksionalitetit të gjykatës, me propozim të Komisionit të Zhvillimit të Karrierës, vendosi:

1. Të shpallë një pozicion të lirë në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Krujë për transferim të përkohshëm deri më datë 01.05.2023.

2. Kjo shpallje i drejtohet gjyqtares së transferuar, aktualisht në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Krujë, znj. {...}, e cila të ftohet për të dhënë pëlqimin për përsëritjen e transferimit të përkohshëm.

3. Afati për dhënien e pëlqimit të jetë brenda dy ditëve nga njoftimi i këtij vendimi.

4. Ngarkohet Komisioni i Zhvillimit të Karrierës për ndjekjen e hapave të mëtejshëm të procedurës së transferimit të përkohshëm.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

* * *

(Pika 1 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2022

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 21.09.2022)

Pika 2 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Për caktimin e gjyqtarëve për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në gjykata të tjera, të ndryshme nga ajo ku ushtrojnë funksionet në mënyrë të përhershme”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Klodian Kurushi).

Drejton mbledhjen Zëvendëskryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, zoti Ilir Rusi.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:00 dhe mbaroi në orën 12:20.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- | | |
|---------------------------|---------------------------------|
| 1. Ilir Rusi | <i>(zëvendëskryetar)</i> |
| 2. Klodian Kurushi | <i>(anëtar)</i> |
| 3. Fatmira Luli | <i>(anëtare)</i> |
| 4. Irena Plaku | <i>(anëtare)</i> |
| 5. Dritan Hallunaj | <i>(anëtar)</i> |
| 6. Ridvan Hado | <i>(anëtar)</i> |
| 7. Alban Toro | <i>(anëtar)</i> |
| 8. Marçela Shehu | <i>(anëtare)</i> |
| 9. Yllka Rupa | <i>(anëtare)</i> |

Shënim: Nuk mori pjesë në mbledhje Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, *znj. Naureda Llagami*, si dhe nuk mori pjesë në mbledhje anëtarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, *znj. Brikena Ukperaj*.

Merrnin pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.

2. Luan Dibra, Drejtor i Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.

3. Maela Alicanaj, Këshilltare Ligjore pranë Njësisë Mbështetëse të Komisioneve të Përhershme të Këshillit.

4. Staf administrativ i KLGJ-së.

RENDI I DITËS:

2. Shqyrtimi i projektvendimit “Për caktimin e gjyqtarëve për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në gjykata të tjera, të ndryshme nga ajo ku ushtrojnë funksionet në mënyrë të përhershme”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Klodian Kurushi).

Çështja e cila është për trajtim si pikë e dytë në rendin e ditës së sotshme lidhet me caktimin e gjyqtarëve për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në gjykata të tjera, të ndryshme nga ajo ku ushtrojnë funksionet në mënyrë të përhershme.

Fjala i jepet relatorit të çështjes, z. Klodian Kurushi.

Fjalën për relatimin e dy relacioneve të përgatitura nga KZHK, e merr zonja Alicanaj, e cila parashtron shkurtimisht se Komisioni ka sjellë përpara Këshillit kërkesat e dy gjykatave, atë të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë dhe të Gjykatës së Apelit Korçë për një çështje me karakter tepër urgjent.

Propozohet që së pari të shqyrtohet çështja e Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë dhe më pas të vijohet me kërkesën e Gjykatës së Apelit Korçë.

Ndër të tjera, në relacion thuhet që, **Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë** ka paraqitur nevojë për 2 çështje gjyqësore (sqarohet se, të gjithë gjyqtarëve të gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë u është pranuar kërkesa për heqje dorë pasi kanë gjykuar numër të konsiderueshme çështjesh dhe janë shprehur më parë me vendime për këto palë).

Për nevojat si më lart të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, në pamundësi të zbatimit të mekanizmave të skemës së delegimit dhe të transferimit të përkohshëm të gjyqtarit, bëhet i nevojshëm zbatimi i nenit 170/1, të Ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe vendimit të KLGJ-së “Për rregullat dhe procedurën e caktimit të gjyqtarit për gjykimin e një çështjeje gjyqësore të veçantë, në një gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme”.

Sa më sipër, propozimet e Komisionit janë:

Gjykata nga duhet të përzgjidhet, me short, gjyqtari që do të caktohet për gjykimin e 2 çështjeve gjyqësore të veçanta, të jetë Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Korçë, për shkak të ngarkesës relativisht të ulët.

Numri i gjyqtarëve që duhet të caktohen për gjykimin e 2 çështjeve gjyqësore të veçanta, të jetë 2.

Propozimet vijuese të Komisionit janë:

Në shortimin e çështjes në ndryshim nga rregulli i zakonshëm të mos përjashtohet nga shorti zëvendëskryetari i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Korçë: z. Ligoraq Toshi.

Anëtarët e Këshillit nuk kanë kundërshtime ndaj propozimeve të Komisionit dhe kështu vijohet me hedhjen e shortit elektronik.

Nga shorti elektronik përzgjidhen (referuar tabelës në relacion):

Për çështjen nr. 2, gjyqtarja Etleva Gjamo.

Për çështjen nr. 1, gjyqtari Ligoraq Toshi.

Vijohet me relacionin e dytë, ku ndër të tjera thuhet që **Gjykata e Apelit Korçë** ka paraqitur nevojë për 1 çështje gjyqësore, në lëndë penale, të karakterit tepër urgjent.

Në lidhje me këtë çështje Këshilli ka caktuar gjyqtaren Emona Muçi me vendim, e cila pasi ka studiuar aktet e dosjes ka vërejtur se ka shkak papajtueshmërie dhe ka dhënë dorëheqjen e cila është pranuar nga kryetarja e Gjykatës së Apelit Korçë. Në këto kushte ka ardhur sërish kërkesa e kësaj gjykate për caktimin e një gjyqtari për plotësimin e trupit gjykues.

Në kushtet kur seanca është caktuar në datë 23 shtator dhe po në këtë datë parashikohet që të shkojnë gjyqtarë nga Gjykata e Apelit Tiranë për të zhvilluar çështje në Gjykatën e Apelit Korçë, atëherë Komisioni ka propozuar që shorti të zhvillohet mes gjyqtarëve të Gjykatës së Apelit Tiranë (Alma Ahmeti dhe Lutfije Celami) që më datë 23 do të shkojnë në Korçë.

Pra propozimet e Komisionit janë:

Gjykata nga duhet të përzgjidhen, me short, gjyqtarët që do të caktohen për gjykimin e 1 (një) çështjeje gjyqësore të veçantë, të jetë Gjykata e Apelit Tiranë.

Numri i gjyqtarëve që duhet të caktohen për gjykimin e 1 (një) çështjeje gjyqësore të veçantë, të jetë 1 (një).

Për 1 (një) çështje, për të cilën kërkohet 1 (një) gjyqtar, të përzgjidhen me short nga gjyqtarët e Gjykatës së Apelit Tiranë të cilët janë të planifikuar për të gjykuar çështje gjyqësore në Gjykatën e Apelit Korçë datë 23 shtator: Alma Ahmeti dhe Lutfije Celami.

Anëtarët e Këshillit nuk kanë kundërshtime ndaj propozimeve të Komisionit dhe kështu vijohet me hedhjen e shortit elektronik.

Nga shorti elektronik përzgjidhet (referuar tabelës në relacion):

Për çështjen nr. 1, penale, gjyqtarja Alma Ahmeti (Zhupa).

Pas hedhjes së shortit mbledhja deklarohet e mbyllur.

* * *

(Mbledhja deklarohet e mbyllur)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor